

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
QENDRA RINORE TEN

Nr. 45/4 prot.

Tiranë, më 18, 03, 2024

NJOFTIM

Drejtuar: Operatorëve ekonomikë; Shoqëri Tregtare, Agjensi Ndërmjetësimi e Pasurive të Paluajtshme; Persona Fizikë apo Individë që kanë në pronësi ambiente për dhënie me qira për zyra.

Lënda: Kërkesë për marrjen e ambienteve me qira për zyra dhe aktivitetin e ushtruar nga Qendra Rinore TEN

Me qëllim përmbushjen të nevojave për zyra dhe aktivitetin e ushtruar nga Qendra Rinore TEN, kërkojmë ambiente me qira sipas specifikimeve të mëposhtme:

Kriteret, specifikimet e ambientit dhe dokumentacioni që kërkohet nga ofertuesi qiradhënës.

1. Bashkia Tiranë kërkon të marrë me qira ambjent të përshtatshëm për *marrje ambienti me qira për zhvillimin e aktiviteteve artistike, akomodimin si dhe sistemimin e punonjësve të Drejtorisë Qendra Rinore TEN* me këto kriterë dhe specifikime si më poshtë vijon:
 - a) Të ketë certifikatë pronësie.
 - b) Të ketë kushte të plota për të qenë e aksesueshme për qytetarët (të ketë vizibilitet, akses për personat me aftësi të kufizuar).
 - c) Të ketë mbi 5 ambiente të ndara për të mundësuar zhvillimin e aktivitetit të Qendrës Rinore TEN.
 - d) Të ketë tualet, ndricim të përshtatshëm, ujë.
 - e) Të ketë sistem sigurie kamera monitorimi.
 - f) Të ketë sistem sigurie kundër zjarrit.
 - g) Sipërfaqja e ambientit të jetë mbi **450 m²**



2. Oferta e qiradhënësit duhet të jetë e shoqëruar me:

- Kërkesa e subjektit/individit për pjesëmarrje në konkurrim;
- Deklarata e hollësishme për vënien në funksionim të objektit;
- Gent-plani i pasurisë.
- Fotokopje e noterizuar e çertifikatës së pronësisë dhe kartelës së pasurisë ose të dokumentacionit që është ndërtuar në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe të procedurës për pajisjen me certifikatë pronësie
- Përshkrim i gjendjes së ambjentit.
- Përshkrim i gjendjes së paisjeve të tij, nëse ka brenda ambjentit objekt i qiradhënies.
- Fotokopje e kartës së identitetit të ofertuesit qiradhënës.
- Ekstrakti QKR-së (nqs është subjekt tregtar).
- Oferta e qiradhënësit duhet të specifikojë çmimin mujor të qirasë.
- Vertetim nga OSHE dhe UKT që nuk ka detyrime
- *Objekti qiradhenes duhet të ketë një ambjent të përshtatshëm që të shërbejë si arkiv për dokumentacionin.*
- Të interesuarit (ofertuesit qiradhënës) duhet të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin brenda Datës 02.04.2024 në Drejtorinë e Qendrës Rinore TEN Institucion në varësi të Bashkisë Tiranë.
- *Kontrata e qiramarrjes quhet e lidhur dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga Qendra Rinore TEN (Qiramarrësi) dhe Ofertuesi (qiradhënës) i shpallur fitues.*

3. Oferta fituese do të jetë:

- Oferta e cila, në bazë të kriterëve dhe kërkesave të përcaktuara në “**Njoftimin për Publikim**” i cili është afishuar në stendën e Qendrës Rinore TEN plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktor për objektin e kontratës së qiramarrjes me çmimin më të ulët, ose
- Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në “**Njoftimin për Publikim**” i cili është afishuar në stendën e Qendrës Rinore TEN plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktor për objektin e kontratës së qiramarrjes

